

**TREGU I PLEHRAVE KIMIKE DHE
PESTICIDEVE NE SHQIPERI**



Studim i realizuar nga
**AGJENSIA RAJONALE E ZHVILLIMIT
(SME) TIRANE**

Ky studim eshte kerkuar nga
BANKA KOMBETARE TREGTARE



dhe mundesuar me financim nga
**FIRMA AGROIMPOT
TIRANE**

Tregu i plehrave kimike dhe pesticideve ne Shqiperi perben nje nga tregjet me konkret dhe te rendesishme per sektorin e bujqesise. Nder konsumatorët me te medhenj te plehrave do te rradhishim: (i) fermat e medha dhe te vogla; (ii) serat e perimeve dhe luleve etj. Rendesit e madhhe merr ky sektor per prodhuesit vendas, tregtarët e importuesit ne pergjithesi, por indirekt dhe per konsumatorin. Proceset e hapjes ekonomike, fuqizimi i prodhimit vendas bujqesor dhe liberalizimi tregtar i japin ketij studimi nje vlere aktuale.

Ky sektor ze nje peshe te rendesishme per sa i perket zhvillimeve te bujqesise sot dhe per ate qe diskutohet dhe ne qarqet akademike lidhur me ceshtje te nxehta si:

- (i) a mund te zhvillohet nje bujqesi pa plehra kimike pra drejt prodhimit te produkteve BIO;
- (ii) cfare tendence ka sot importimi dhe prodhimi i plehrave te kombinar; (iii) cila eshte shija konsumatore ne zhvillim;
- (iii) cfare ngarkese plehrash kimike duhet te perqendrohet ne siperfaqe toke te puneshme per kategori te ndryshme produktesh te mbjella etj.

Studimet dhe kerkimet e tregut jane nje nga produktet me te rendesishme te programit te ARZH, Ky studim merr shkas nga shqetesimet e vete komunitetit te biznesit, por dhe te bankave per njohjen, mbeshtetjen dhe aktualizimin e problematikes lidhur me oportunitetet qe fsheh ky treg gjithnje ne ndryshim te vazhdueshem si nga stili ashtu dhe nga shija konsumatore.

Per kryerjen e ketij studimi eshte angazhuar stafi i ARZH Tirane: Ilir Rembeci- Drejtori i ARZH; Edmond Sheshi- Kordinator i Rrjetit te ARZH ; Dolores Sinanaj – Specialiste Kerkimesh prane ARZH ; Jorgo Dhimarko- Konsulent prane ARZH; Roland Lami Specialsit kerkimesh prane ARZH .

Studimi eshte mbeshtetur ne nje proces mbledhje informacioni, elaborimi te tij, analizash teorike, praktike, nje seri intervistimesh te tregtuesve te vegjel por dhe te medhenj, perdorim te statistikave dhe informacioneve fale bashkepunimit me ACIT/ISB, INSTAT, Instituti i Tokave, dhe Doganes Tirane.

Drejtues i studimit eshte Z. Ilir Rembeci Drejtor Eksekutiv i Agjensise Rajonale te Zhvillimit (SME) tirane.

STUDIMI I TREGUT TE IMPUTEVE BUJQESORE NE SHQIPERI

I. NJE VESHTRIM I PERGJITHSHEM I TREGUT TE PLEHRAVE KIMIKE

- Objekti i studimit, metodologjia e tij
- Analiza e sektorit te bujqesise dhe roli I plehrave kimike per te.

II.MADHESIA E TREGUT

- Madhesia e tregut te plehrave (prodhim, import dhe eksport), segmentimi I tregut dhe tendenca e tij.
- Historiku i prodhimit te plehrave ne Shqiperi
 - Konsumi ne bote dhe Shqiperi (statistika if)
- Llojet e plehrave qe hyjne ne Shqiperi (fosfatike, kimike, pesticide, organike etj).
- Prodhuesit kryesore ne vend
- Sasite e prodhuara ne vend
- Sasite e importuara ne 3 vitet e fundit, firmat importuese
- Cmimet e blerjes nga importi dhe shitjes se plehrave ne vend
- Efektiviteti ekonomik i perdorimit te pleherave
- Potencialet magazinuese ne vend (Numri I magazinave doganore ne vend)

III. ANALIZA E KONKURENCES

- Analiza swot e tregut te konkurences
- Firmat importuese te plehrave/Aktoret kryesore
- Konsumatorët e plehrave ne Shqiperi (fermat e medha, fermeret private)
- Furnizuesit kryesore (firmat e huaja) te plehrave
- Kanalet e shperndarjes (Import dhe eksport)
- Profilet e kompanive konkuruese

IV. SJELLJA KONSUMATORE

- Konsumi I plehrave (statistike ne shifra 3 vitet e fundit).

- Tendenca e tregut konsumator(Visioni drejt nje bujqesie organike pa plehra ?)

V.RISQET DHE SFIDAT E SEKTORIT

- Risqet e biznesit sot e ne te ardhmen
- Risku qe paraqet vete vendi.

VI. KONKLUZIONE PER SEKTORIN E PLEHRAVE KIMIKE

VII. TABELA DHE ANEKSE

Shenim: Ky studim duhet te jape te dhena kryesisht per plehrat/pesticide (import) si destinacion per fermeret dhe dicka ne sfond dhe per prodhimin qe ka eksistuar ne vend

I. NJE VESHTRIM I PERGJITHSHEM I TREGUT TE PLEHRAVE KIMIKE

Objekti i studimit, metodologjia e tij

Ky studim behet per te evidentuar tregun aktual dhe ate potencial per kategorite e plehrave kimike te ndryshme te nevojeshme per sektorin e bujqesise. Do te synohet te ofrohet nje pamje e detajuar e tregut kryesisht te kategorive te plehrave te importit, por dhe te iniciativave te rimekembjes se prodhimit te vendit per plehra te vecanta dhe me nje te ardhme. Ne pergjithesi ky material bazohet ne analizimin e kategorive te plehrave kimike te meposhteme.

1. Plehra kimike me baze azoti ku mund te themi dy grupe te medha:
 - Nitrat Amoni 33-34% azot N
 - Ure 45% azot N
2. Plehra me baze fosfati in dare ne dy grupe te medha persa I perket formes se gjendjes se tyre dhe koncentrimin te permbajtjes se lendes active
 - Superfosfat Pluhur me permbajtje te lendes active 16-18%
 - Superfosfat me granula (I granuluar) me permbajtje te lendes active 20%
3. DAP Diamonium fosfat
4. NPK plehra te kombinuara azot fosfor kalium plus mikroelemente
5. Plehra potasike me permbajtje 50% te K_2O
6. Plehurat Kristaline. Keto plehra vine ne formet kristalore ose te tretuar ne lengje.
7. Plehrimet Gjethore (Foljare)

Ne fakt kategorite 6 dhe 7 jane plehra te kombinuara pra bejne pjese ne kategorine e NPK^{ve} persa i perket permbajtjes por por ne i kemi nxjere te tilla referuar natyres se tyre te vacnte dhe prespekives se perdorimit te tyre.

Eshte bere ky kategorizim duke menduar se ai perfshin pothuajse 100% te plehrave qe perdoren ne tregun tone.

Krahas nevojave te tregut do te synohet te ofrohet dhe tendenca e sektorit te importit te plehrave per te ardhmen duke bere dhe sugjerimet perkatese sipas argumentit. Natyrisht do te ofrohet dhe nje pamje e firmave, markave kryesore te produkteve, volumit te importit ne vitet e fundit dhe sipas origjines se shteteve nga vijne.

Analizat dhe krahasimet e nivelit te ngarkeses se plehrave kimike per token bujqesore si dhe kategorite e ndryshme te siperfaqeve qe pleherohen do te jene ne nje fokus te rendesishem i ketij studimi gjithashtu.

Nga pikepamja metodologjike, studimi eshte mbeshtetur ne:

- (i) Analizen dhe perpuimin e shifrave dhe vleresimeve statistikore te informacioneve te vjela nga burime si ACIT/ISB, Dogana Tirane, INSTAT, Instituti i Tokave, Ministria e Bujqesise, por dhe te eksploruara nga burimet e vete ARZH.
- (ii) Verifikimit ne terren te problematikes lidhur me kerkesen e fermereve, gamen e importit, llojshmerin e kerkuar, procedurat doganore etj. Jane kryer vizita ne ferma bujqesore Tirane dhe Durres.
- (iii) Nje proces intervistimi me aktore kryesore ne kete treg si Agro Blend, Agroimput, AgroProgres etj (tregtare dhe importues) eshte kryer duke ruajtur dhe konfidencialitetin e burimit te informacionit dhe te studimit per porositesin e tij qe ne rastin tone eshte Banka Kombetare Tregtare Tirane dhe Firma Agroimput.

Analiza e sektorit te bujqesise dhe roli I plehrave kimike per te.

Historik

Bujqesia ne truallin e Shqiperise deshmoheq qe nga **kohet e neolitit**. Fiset liire permendeshin per prodhimin e grurit, te thekres , te rrushit, te vajit te leshit dhe per rritjen e baqetise. Deshmite e shekullit XI flasin per ara e kopeshte me peme ne bregdetin shqiptar. Deri ne **kohen e Skenderbeut** bujqesia ishte dega kryesore e prodhimit.

Bujqesia tradicionale ishte kryesisht bujqesi arash. Rriteshin te lashtat (grure, theker, tershere e mel). Nga shekulli i XVII u perhap gjeresisht misri, bime e tjera si pambuku, duhani, jonxha etj. zinin siperfaqe te kufizuara. Perimet kultivoheshin kryesisht ne zonat fushore, dhe ne zonat e gjera malore ishin krejt te kufizuara. Pleherimi behej me plehun organik te stalles, tokat e reja hapeshin me prerje e diegje te pyjeve dhe me carjen e livadheve. Deri ne fund te shekullit te XIX, megjithe pervojen e fituar per rritjen e disa bimeve dhe me mjeshterine e ujitjes e te brezarimit ne disa krahina, rendimentet ishin shume te uleta.

Pavaresia (1912) e gjeti bujqesine afersisht ne ate gjendje qe e kish lene mesjeta – te prapambetur dhe me ngastra te vogla, me mbeturina te theksuara te maredhenieve feudale. Gjate **regjimit te A.Zogut** bujqesia ngeli me teknologji primitive, pa asnje ndihme te organizuar financiare apo teknike , rendimentet e produkteve ishtin shume te uleta dhe nje pjese e madhe e nevojave te vendit per drithe perballoheshin nga importi.

Mbas clirimit te vendit, me Reformen Agrare dhe me krijimin e sektorit shteteror u krijua bujqesia socialiste. Siperfaqja e tokes se punuar rritej vazhdimisht sipas nje plani te paracaktuar mire dhe toka perfitohej nga bonifikimi, nga shpyllezimi i pyjeve te degraduara, nga hapja e tokave te reja etj. U nxit kultivimi I dritherave dhe bimeve industriale qe hyne per here te pare ne shkalle te gjere ne bujqesine e vendit. Ne fund te vitit **1956 perfundoi ne pergjithesi kolektivizimi** i cila u konsiderua si rruga e vetme per perparimin e bujqesise dhe ndertimin e socializmit ne fshat. **Ne vitin 1985** sektori shteteror (kupto fermat bujqesore) zoteronte 21.4 % te tokes se punueshme, ndersa sektori kooperativist me koperativat bujqesore te tipit te larte dhe me kooperativat e tjera bujqesore kishin ne perdorim 75.7% te tokes se punueshme.

Detyrat themelore e bujqesise ishin sigurimi i bukes ne vend gje qe ishte e lidhur ngushte me politiken e ndjekur te ① “Mbeshtetja ne Forcat Tona” si dhe me sigurine ne rast te nje lufte te gjate. Gjate gjithë periudhes se regjimit ② u hapen toka te reja duke u thare kenata, punuar kodra e kullota dhe kthyer ato ne toka pjellore. Gjate kesaj kohe ③ u kultivuan ne menyre ekstenzive shume bime industriale, perime, patate dhe foragjere. Ne frutikulture e vreshtari ④ u ngriten masive te medha pemesh, vreshtash dhe ullinjsh. Masa te rendesishme u moren per te siguruar nje ⑤ sistem te gjere kullimesh dhe rezervuare ujitjesh. Ne koperativat dhe ndermarrjet bujqesore ⑥ punimet kryheshin kryesisht me mjete te mekanizuara. Zhvillim te vullshem ne drejtim te rendimentit te kulturave bujqesore pati ne menyre te vecante perdorimi ne bujqesi i ⑦ pleherave kimike ne shkalle te gjere mbas prodhimit te tyre ne vend. Ketu permendim prodhimin e pleherave azotike ne Uzinen e Azotikut ne Fier dhe ate te superfosfatit ne Lac. Po keshtu ⑧ lufta ndaj semundjeve dhe demtuesve ne bujqesi realizohej me ane te pesticideve te ndryshme qe kryesisht prodhoheshin ne uzine kimike Durres. Ne mbeshtette te te gjithë sistemit u krijuan nje sere ⑨ institucionesh kerkimore shkencore te cilat u bene nje mbeshtetje e fuqishme per zhvillimin e bujqesise. Ne mbeshtetje te kesaj ⑩ u krijuan nje sistem i tere magazinash dhe depozitash per plehrat kimike, pesticidet dhe plehrat organike.

Te gjitha keto ndryshime ne bujqesi nuk paten ndonje ndikim te ndjeshem ne permiresimin e kushteve te jeteses e te punes ne fshat, ne ngushtimin e dallimeve thelbesore ndermjet fshatit e qytetit dhe kjo me teper per faktin se ndarja e te ardhurave nuk behej duke patur per baze punen, por cdo gje behej e planifikuar dhe ishte e centralizuar. Sigurisht qe ky fakt ndikoi shume ne uljen interesit te fshataresise per te punuar, ata per here e me teper po e kuptonin se puna e tyre nuk shperblehesh si duhet. Programet e mepasme te ngushtimit te oborrit koperativist si dhe ato te krijimit te tufezave dhe arezave jo vetem qe ndikuan negativisht ne nivelin e jeteses se fshataresise por gjithashtu paten nje efekt negativ edhe ne zhvillimin e bujqesise ne pergjithesi. Mbeshtetur ne pronen shteterore pra prona e te gjithëve dhe ne fakt e askujt coi ne degradimin gradual te te gjithë prodhimeve ne bujqesi. Zgjerimi i puneve ne bujqesi dhe mos mekanizimi e futja e teknologjive te reja ne kete fushe te jetes beri qe ne vendin tone nje pjese e madhe popullsise te ngelej ne zonat rrurale pra vendi te kish nje popullsi reth 70% fshatare. Me kolapsin e tre prodhuesve kryesore te plehrave kimike ne fund te viteve 80 e fillim te viteve 90 rendimentet e prodhimeve dhe sasite e tokave te punuara rane menjehere.

Aktualitet

Mbas zhvillimeve politike te viteve 90-te pra me ndryshimin e sistemit shoqeror, ndodhen nje sere ndryshimesh edhe ne ekonomine bujqesore. U be privatizimi i tokes se koperativave bujqesore dhe ndermarrjeve shteterore gje qe krahas anes pozitive te krijimit te sektorit privat ne bujqesi pati edhe shume ane negative. Te tilla mund te permendim shkaterrimin e shume ekonomive te perqendruara e te specializuar si vreshtat, ullishtet, serat, pemtarite etj., demtimin e sistemeve te kullimit dhe ujitjes si dhe shkaterrimin e shume sistemeve te tjere te sherbimit. Copezimi i tokave ne ngastra te vogla, shkaterrimi i SMT-ve dhe mungesa e mjeteve te mekanizuara per punimin e tokes, mungesa e njohurive te nevojshme te zhvillimit te bujqesise ne kushtet e ekonomise se tregut, konkurenca e

tregetise se lire ne fushen e prodhimeve bujqesore e shume faktore te tjere bene qe mbas viteve 90-te te kemi nje renie te theksuar te prodhimit bujqesor si rrjedhoje edhe te plehrave kimike e pesticideve.

Vendi yne ka nje trashegimi kulturore ne perdorimin e plehrave kimike te karakterit masiv sic jane ato azotike e fosfatike, kjo aftesi eshte perfituar nga periudha e ekonomise se centralizuar. Pervec plehrave te perdorura gjate asaj periudhe sot ne treg kane hyre edhe plehra kimike te tipeve te reja dhe shume efektive. Sot themi qe plehrat kimike i grupojme ne shtate kategori te medha te cilat jane ushqyes te bimeve me elementet e novojshem si dhe nje grup i madh pesticidesh qe jane elemente qe luftojne semundjet e ndryshme te bimeve apo parazitet qe demtojne bimet.

Prodhimi plehrave ne vendin tone eshte nderprere me kolapsin qe pati industria pas viteve 1990. Keshtu Azotiku Fier dhe Superfosfati Lac tashme jane nje vegim i te shkuares

Kategorite e plehrave qe perdoren sot jane ato me perdorim masiv dhe ato qe kane perdorime me sasi te vogla ku mund te fusim:

Plehra massive dhe kryesisht me nje element baze.

- a) Plehra kimike me baze azoti ku mund te themi dy grupe te medha 1-Nitrat Amoni, 2-Ure;
- b) Plehra me baze fosfati ku edhe keto mund te permendim dy grupe te medha persa I perket formes se gjendjes se tyre dhe koncentrimin te permbajtjes se lendes active 1-Superfosfat Pluhur me permbajtje te lendes active 16-18%, 2-Superfosfat me granula (I granular) me permbajtje te lendes active 20%;
- c) DAP Diamonium fosfat

Plehrat me sasira te vogla perdorimi dhe me shume elemente perberes

- d) NPK plehra te kombinuara;
- e) Plehra potasike me permbajtje 50% te K₂O;
- f) Plehrat Kristaline te cilat importohen kristalore ose te tretuar ne lengje te ndryshme;
- g) Plehrimet Gjethore (Foljare)

Pesticidet jane elemente qe sillen nga importi dhe jane te llojeve te ndryshme per to mund te permendim disa kategori si:

- Insekticide
- Fumicide
- Mbrojtes nga demtuesit e tokes
- Te shendetit publik etj.

Procesi i prodhimit te plehrave




Figura 1: Marre ne Internet ne faqen e shoqates se prodhuesve europiane te Fertilizer

Aktualisht plehrat kimike sot sigurohen krejtesisht nga importi. Origjina e importimit te plehrave eshte e ndryshme, keshtu mund te evidentojme faktin qe plehrat Azotike kane kryesisht origjinen e blerjes nga Rusia, Ukraina dhe nje pjese nga Bullgaria por qe edhe keto te fundit mundet qe origjinen ta kene po nga Rusia. Plehrat Fosfatike vijne kryesisht nga vendet arabe dhe pikerisht nga Marok, Egjypt dhe me ralle nga Algjeria. DAP vjen nga Tunisa ndersa NPK kane orgjinen nga vende te ndryshme por qe ne vendin tone importohen nga vendet fqinje si Itali e cila siguron rreth 80% e sasie se pergjithshme dhe Greqia rreth 20% te sasise. Plehrat potasike vijne nga vendet e mesdheut, plehrat kristaline vijne kryesisht nga Spanja, Franca, Itali, Izrael dhe se fundmi plehrat gjetore vijne nga shtete te ndryshme. Pesticidet kane origjine prodhimi te ndryshme si Gjermani, Amerike, Itali, France Rusi etj por qe ne vendin tone ato importohen kryesisht nga Italia dhe Greqia.

II. MADHESIA E TREGUT

Madhesia e tregut te plehrave (prodhim, import dhe eksport), segmentimi i tregut dhe tendenca e tij.


Madhesia e tregut te plehrave kimike eshte ne zhvillim e siper. Gjithnje e me teper me shtimin e mekanizimit dhe akumulimit te vazhdueshem te te ardhurave fermeret shtojne investimet ne zgjerimin e siperfaqeve qe perpunohen si rrjedhoje edhe sasine e plehrave e pesticideve qe kerkohet.

Objekte kryesore te pleherimit kimik e organik jane:

1. Siperfaqet e mbjella me foragjere te njoma	185,000 ha
2. Siperfaqet e mbjelle me drithera	160,000 ha
3. Siperfaqet e mbjella me peme frutore	117,050 ha
4. Siperfaqet e mbjella me pjergulla	90,200 ha
5. Siperfaqet e mbjella me ullinj	70,800 ha
6. Siperfaqet e mbjella me perime e bostan	32,000 ha
7. Siperfaqet e mbjella me fasule	17,500 ha
8. Siperfaqet e mbjella me patate	10,500 ha
9. Siperfaqet e mbjella me agrume	9,000 ha
10. Siperfaqet e mbjelle me vreshta	7,200 ha
11. Siperfaqet e serave	750 ha

GJITHESEJT

700,000 ha



Sa eshte realisht mundesia e perdorimit te plehrave ?

Ne baze te ketyre siperfaqeve aktuale dhe normativave te perdorimit te plehrave per 1 Ha e cila jepet ne tabelen e meposhteme do te gjejme realisht edhe sasine e plehrave qe duhen perdorur.

Numrat shprehin sasine e Kv te Plehut per 1 Ha

Emertimi	Nitrat	Ure	Superfosfat	DAP	NPK	Potas	Kristalor
Drithra	2	2	4	2			
Jonxh			3-4	1.5			
P.Frutore	0.5	0.5					
Vreshta	2	5		7 ¹	7		
Ullinj	1	3			4		
Agrume	1	3			3		
Pjergulla		0.5					
Sera		1	1	2	3		1
Bostan Perime		4		3			
Fasule		1	2	1			
Patate			2			1	

Shenim: Ne rastin e dritherave shifrat duhen shumezuar me nje koeficient 1.2-1.4 mbasi cikli I pleherimit te tokes eshte me I paket se nje vit. Ne konsumatoret e tjhere cikli I pleherimit eshte vjetor.


Sasite jane ne Mije Ton

Emertimi	Siperfaqet Ne Ha	Nitrat	Ure	Superfos	DAP	NPK	Potas	Kristalor
Drithra	160000	41.6	41.6	83.2	41.6	-	-	-
Jonxh	185000	-	-	64.8	27.8	-	-	-
P.Frutore	117500	5.9	5.9	-	-	-	-	-
Vreshta	7200	1.4	3.6	-	5.0	5.0	-	-
Ullinj	70800	7.1	21.2	-	-	28.3	-	-
Agrume	9000	0.9	2.7	-	-	2.7	-	-
Pjergulla	90200	-	4.5	-	-	-	-	-
Sera	750	-	0.1	0.1	0.2	0.2	-	0.1
Bosta Perime	32000	-	12.8	-	9.6	-	-	-
Fasule	17500	-	1.8	3.5	1.8	-	-	-
Patate	10000	-	-	2.0	-	-	1.0	-
Totali	700,000	56.9	94.2	153.5	5.9	6.3	1.0	0.1

¹ Ne vreshtari perdoret vetem njera nga llojet e plehrave DAP ose NPK nuk mund te hidhen te dyja njekohesisht.

Pra ne Total madhesia e Tregut te plehrave ne shqiperi eshte reth 430 mije Ton

Nje nder perdoruesit kryesore te plehrave te kombinuara sot jane serat e prodhimeve te produkteve ushqimore si dhe serat e luleve dhe pak edhe popullata. Saiste e konsumuara prej tyre ne krahasim me plehrat massive (Nitrat, Ure, Superfosfat, DAP) jane jo te krahasueshme, ndersa persa u perket vlerave ato jane te konsiderueshme. Sic shikohet edhe nga tabela e grafiku sasia e siperfaqeve te serave ka nje ecuri ne rritje e cila ka tendence te tille edhe per vitet ne vazhdim. Keshtu vetem gjate vitit 2004 shtimi i sip se serave ka kaluar nga 552Ha ne reth 750 Ha. Megjithate ne vendin tone ne mes te viteve 80 ne kemi patur nje siperfaqe me sera reth 3500Ha.




Siperfaqja dhe rendimenti I prodhimit te perimeve ne sera

Emertimi	1991		1995		2000		2002		2003	
	Sip. Ha	Rend Kv/ha	Sip. ha	Rend Kv/ha	Sip. Ha	Rend Kv/ha	Sip. ha	Rend Kv/ha	Sip. ha	Rend Kv/ha
Sera gjithesej	1073	682	231	454	462	835	524	814	552	854
Sera me ngrohje	118	935	23	667	17	992	13	675	19	847
Sera diellore	955	651	208	431	445	829	496	795	533	795
- me xham	225	735	130	445	114	770	70	596	88	614
- ne plasmas	730	625	77	408	331	849	426	845	445	920

Nga kjo table mund te vihet re fare mire ndikimi I pleherimit ne vite po te shikoni rendimentet, ne serat me plasmas, ato vijne duke u rritur keshtu kundrejt vitit 1995 ne vitin 2003 kemi nje rritje 225%. Ne rast se e studjojme fenomenin shohim qe ne vitin 1991 perseri rendimenti ka qene I larte kjo per faktin se edhe atehere ato pleheroeshin shtesat e vitit 2003 kundrejt 1991 eshte vetem 26% gje

e cila pjeserisht I dedikohet plehrave te kombinuara NPK qe ne ate kohe nuk egzistonin pothuajse fare si dhe kujdesit te treguar nga ana e pronareve private. Kjo skem eshte shprehur qarte edhe me ane te grafikut te me poshtem.



Nje rendesi e vecante po I kushtohet gjate ketyre viteve sektorit te prodhimit te frutave, ullinjeve dhe vreshtave. Kjo gje duket qarte edhe nga fakti se siperfaqja e mbjelle me to si dhe numuri I rrenjeve te kultivuara sa vjen e shtohet. Po ti referohemi tabelës se meposhteme shifet qarte se numuri I rrenjeve te drufutoreve per vitin 2003 ka qene 6,530,000 nga 3,583,000 qe ishte ne vitin 1992 pra gadi eshte dyfishuar; numuri ullinjeve nga 3,129,000 rrenje ne 3,940,000 ne vitin 2003. Ajo qe te bie me shume ne sy eshte rritja e konsiderushme rendimentit te prodhimit te rrushit ne vreshta, nga 17,6 kv/ha ne vitin 1992 ne 90.0 kv/ha ne vitin 2003.

Numuri i rrenjeve te drufutoreve dhe vreshtave (ha)per vitet 1992-2003

Nr.	Emertimi	1992	1996	2000	2002	2003
I	Peme frutore					
	Gjithesej(000 rrenje)	3583	5072	5573	6029	6530
	Ne prodhim(000 rrenje)	2867	4012	4179	4524	4875
	Rendimenti (kg/rrenje)	11.9	14.5	15.5	16.8	15.9
II	Ullinj					
	Gjithesej(000 rrenje)	3129	3405	3611	3809	3940
	Ne prodhim(000 rrenje)	2313	3084	3256	3290	3359
	Rendimenti (kg/rrenje)	8.7	9	11.1	8.3	8.3
III	Agrume					
	Gjithesej(000 rrenje)	364	420	391	453	489
	Ne prodhim(000 rrenje)	305	361	305	322	363

	Rendimenti (kg/rrenje)	42.4	8.3	8.8	10.7	12.0
IV	Pjergulla					
	Gjithesej(000 rrenje)	2615	4064	4638	4806	5022
	Ne prodhim(000 rrenje)	2233	3370	3856	4060	4259
	Rendimenti (kg/rrenje)	12.1	11.7	11.9	10.3	12.6
V	Vreshta					
	Gjithesej(000 rrenje)	7285	5024	5824	6800	7180
	Ne prodhim(000 rrenje)	6193	4375	4613	5202	5741
	Rendimenti(kv/ha)	17.6	49.3	70.5	79.4	90.0

Burimi I informacionit: Drejtoria e statistikes/MBU - 2003

Ne tabelen e mesiperme kemi nje tregues shume te mire per sa i perket efektivitetit te perdorimit te plehrave kimike dhe potencialit te tregut te perdorimit te tyre. Ne tabelen e mesiperme kemi pseze zera Peme frutore, Ullinj, Agrume, Pjergulla, Vreshta nga te pese keto grupe ju do te shikoni qe zerat te cilat jane mbjelle dhe shtuar per qellime fitimi sic jane pemet frutore dhe vreshtat kane rritje te rendimenteve kjo sepse ne to perdoret ne menyre efektive pleherimi kimik ndersa ne zerat e tjera sic jane Agrumet Pjergullat dhe deri diku Ullinjte qe nuk ju behet ndonje izmet i madh, persa i perket pleherimit, por i lihet prodhimi ne spontanitet shikohet qe rendimentet jane pothuajse te pa levizura. Ne kete madhesi tregu ka hapsira te konsiderueshme per perdorim te plehrave kimike. Nese analizojme vetem Agrumet shikojme qe rendimenti i tyre ne vitin 1992 ka gene reth 4 here me i madh kjo tregon se ne ate vit akoma kemi efektet e plehrimit masiv te viteve te ekonomise se centralizuar si dhe te kujdesit te organizuar te kultivimit te tyre, sot qe cdo gje eshte private mungesa e ushqimit me plehra ben qe ky rendiment te jete ne kufijte e poshtem.

Nje permiresim i ndjeshem vihet re edhe ne drejtim te perdorimit te plehrave kimike krahas atyre organike nga ana e fermerëve shqiptare. Sasite e plehrave qe perdoren, megjithese larg atyre te vendeve me bujqesi te zhvilluar jane relativisht te kenaqeshme. Kjo duket qarte po te kemi parasysh shifrat e perdorimit total te plehrave kimike te paraqitura ne tabelen e meposhteme dhe siperfaqen e tokes bujqesore te vendit tone qe eshte afersisht rreth 700 mije hektare (120,000 ton plehera kimike/700,000 ha toke= 170 kg/ha). Ndoshta ketu mund te kete vend akoma per rritjen e sasise se perdorimit te ketyre plehrave, rritjen e games se asortimenteve te tyre dhe ne menyre te vecante per teknologjine e kombinimit dhe perdorimit te tyre.

Pervec plehrave kimike massive dhe atyre te kombinuara gjithemone dhe ne menyre te domozdoshme me plehera organike, fermeret shqiptare perdorin edhe pesticide te ndryshme, referuar shifrave te dhena ne tabelen perkatese rreth 60% e fermerëve i perdorin keto pesticide. Me gjeresisht ato perdoren ne rastin e perimeve te ndryshme si dhe ne dru frutoret dhe ullinjte.

Per permiresimin e gjendjes se krijuar ne bujqesine dhe blegtorine e vendit, jane kryer nje sere investimesh nga shteti, privatet dhe investime te huaja. Keto investime jane realizuar kryesisht me fonde te donatoresh nje sere nepermjet nje sere projektesh te rendesishme. Investimet kane ndikuar ne menyre te ndjeshme ne zgjerimin e tregut ne pergjithesi duke perfshire ketu edhe ate treg ku perdoren plehrat ne vecnati. Ne tabelat e meposhteme po paraqesim realizimin e

financimit te projekteve dhe investimeve ne sistemin e bujqesise per periudhen 1999 – 2003.

Realizimi I financimeve te projekteve

Mln.Lek

Nr.	Projekti	1999	2000	2001	2002	2003
1.	Rehabilitimi I ujitjes B. Boterore	890	1128	1290	1610	1855
2.	Projekti I Zhvillimit Rural (SIDA)	-	-	-	161	22
3.	Projekti I tokes (USAID)	312	338	260	86	113
4.	Projekte Italiane	-	-	-	53	10
5.	Projekti I Sherbimit Bujqesor	-	47	53	107	285
6.	Projekti I Peshkimit	-	3	42	66	121
7.	2KR	-	654	89	528	302
8.	Programi PHARE	318	588	368	434	210
9.	Projekti Zhvill. Zonave malore IFAD III					
10.	Projekti i Statistikes	-	-	-	7	10
11.	Projekti I pyjeve	161	265	479	557	373
12.	Mbereshtrimii Lopes Xhersej	-	-	-	6	9
13.	Projekti FAO, GTZ, Italiane	-	-	-	-	10
	Totale	3337	4108	2918	4322	3899
-	Investim I huaj	2683	3345	2269	3418	3076
	Financim kosto locale nga Qeveria					
-	Financim te TVSH	347	379	331	497	383

Burimi i informacionit: Drejtoria e Statistikes/MBU - 2003

Investimet ne sistemin e bujqesise

Nr.	Emertimi	1999	2000	2001	2002	2003
1.	Investimi huaj	2683	3345	2269	3418	3945
2.	Investime nga shteti	1132	1522	1366	1668	1385
-	Financime direkte	478	758	717	764	601
-	Financim kosto lokale nga Qev. Shqiptare	307	384	318	407	408
-	Financim te TVSH	347	379	331	497	376

Sic shihet nga tabelat e mesiperme, per vitin 2003 financimet e huaja jane gati trefishi I atyre te kryera nga shteti, ndersa ne financimin e projekteve gadi gjysma e fondeve jane destinuar per projektin e reabilitimit te ujitjes, projekt ky I financuar nga Banka Boterore.

Plot financime ka edhe nga private vetem per sera po te llogarisim me nje mesatare 1 milion leke per dynym sere e mbuluar me plasmas rjedh qe gjate ketyre viteve jane investuar reth 7500 milion leke vetem per siperfaqet e serave.

Historiku i prodhimit te plehrave kimike ne Shqiperi

Do te bejme nje historik te shkurter ne lidhje me prodhimin e plehrave ne Shqiperi para viteve 90.

Ne vendin tone ne kohen e ekonomise se centralizuar prodhoheshin ne menyre masive plehra kimike dhe pesticide. Prodhimi I ketyre plehrave realizohej ne uzinen e Azotikut Fier nepermjet instalimit te nje teknologjie kineze ku sasia e prodhimit ne vit ishte rreth 120 mije ton plehra. Ne kete uzine prodhohej kryesisht plehra si: Azotike Nitrat Amoni dhe Ure sasite e prodhimit te ketyre plehrave nga viti ne vit erdhi duke u zvogeluar duke arritur nivelin zero.

Nder faktoret kryesore qe ndikuan ne uljen e sasive te prodhimit ishin: kostoja e tij ishte shume e larte, burimi energjistik qe sherbente si lende e pare gazi natyror nuk kishte rezerva te vazhdueshme, ndotjet e medha te ambientit mbi normat e lejuara, acidi nitric i koncentruar deri 98% qe sigurohej nga kombinati kimiko metalurgjik i Lacit nuk prodhohej me.

Nje prodhim ne sasira te konsiderueshme kishte edhe per sa i perket plehrave fosfatike te cilat prodhoheshin ne Lac me nje kapacitet prodhimi rreth 180 mije ton ne vit. Ecuria e prodhimit te plehrave fosfatike erdhi duke u zvogeluar sepse prodhimi u influencua nga disa faktore si: Lenda e pare sigurohej kryesisht ne vende si: Marok, Egjypt, Algjeri me nje kosto blerjes shume te shtrenjte, pamvarsisht se kjo lend kishte permbajtje te mire te lendes active rreth 24-30%. Vetem 15% e lendes se pare sigurohej nga vemdburimi i Gusmarit ne Fushe-Bardhe te rethit te Gjirokastres dhe kjo lende kishte dy te meta: ishte gure dhe kerkonte thyerje si dhe permbajtja e lendes active me nje fare pasurimi mund te arrinte max -22%, shpesh ajo mberinte ne Lac me permbajtje 12-18%. Nje factor tjeter I rendesishem ishte teknologjia e dobet e prodhimit te superfosfatit e cila e nxirte superfosfat me nje permbajtje deri ne 12-14% per pluhurin dhe 16-18% per granulatin, nderkohe qe ne vendet e zhvilluara perdorej shume bifosfati me nje permbajtje te larte te lendes active reth 24-28%. Prodhimi u nderpre gjithashtu edhe nga fakti qe acidi sulfurik i cili prodhohej ne uzinen e Lacit dhe perdorej si lende e pare per prodhimin e superfosfatit, me mbylljen e ketyre aktiviteteve u mbyll dhe prodhimi i acidit sulfurik.

Pesticidet para ndryshimeve te medha ekonomike ne vend prodhoheshin kryesisht ne uzinen kimike ne Durres dhe ato ishin teper te forta por kjo uzine u mbyll ne fillimet e ndryshimeve te sistemeve ne Shqiperi. Arsyet qe cuan ne mbylljen e kesaj uzine ishin: teknologjia e vjeter, koston e larta dhe ndotjet e medha te ambientit mbi normat e lejuara. Sot ndotjet e kesaj uzine jane nje problem i madh ekologjik jo vetem per zonen por per gjithe vendin.

Konsumi ne bote dhe Shqiperi

Te dhenat statistikore tregojne se deri ne fillim te shekullit te 19 ne Europen Perendimore rendimenti I drithit ishte rreth 7 kv/ha, por me futjen ne qarkullim bujqesor te terfilit rendimenti arriti deri ne 16 kv/ha nga qe toka u pasurua me azot. Nga fundi I shekullit te 19 me prodhimin e plehrave minerale rendimentet

pesuan rritje te re 26-30 kv/ha. Sot rendimente te larta marrin vendet qe perdorin me shume plehera minerale dhe organike sic paraqitet ne ne kete pasqyre.

Shteti	Lende ushqyese ne toke te punueshme				
	Azot	Fosfor	Potas	NP	NPK
Hollande	293	122	148	415	564
Belgjike	165	124	197	290	487
Gjermani	88	89	133	178	312
Japoni	121	83	98	205	304
Zvicer	54	119	113	173	287
Angli	79	62	60	141	202
Austri	39	66	176	105	182
Danimarke	55	42	63	98	162
France	37	56	48	93	142
Ceki	32	40	50	73	124
Greqi	29	28	4	58	62
Poloni	22	17	23	39	62
Itali	24	23	9	48	56
Hungari	35	19	5	45	51
Jugosllavi	18	12	17	30	47
Bullgari	19	16	2	36	39
Spanje	15	15	5	31	36
Rumani	8	9	1	18	18
Turqi	20	3	1	23	24
SHBA	21	17	13	38	51
Rusi	6	4	4	10	14
Kanada	4	5	3	9	12
Shqiperi	31	15	1	46	47

Llojet e plehrave qe perdoren ne Shqiperi (fosfatike, kimike, pesticide, organike etj).

Pleherat jane materiale qe permbajne elemente te domozdoshem per ushqimin e bimeve bujqesore sic jane azoti, fosfori, kaliumi dhe nje numur I konsiderushem mikroelementesh si mangan, baker, zink, bor etj. Bimet bujqesore, pleherat I pervetesojne dierkt ose indirect, ato jane nje factor i rendesishem ne rritjen e rendimentit dhe cilesise se prodhimit. Lendet ushqyese te plehrave merren dhe pervetesohen nga bimet ne menyre te pernjehereshme ose gradualisht mbas nje fare periudhe nga momenti I perdorimit. Sipas kerkesave biologjike te bimeve, pleherat i shtohen tokes cdo vit apo nje here per disa vjet. Krahas funksionit te tyre kryesor si nje mjet per ushqimin e bimeve dhe rritjen e rendimentit plehrat sherbejne edhe per permiresimin e vetive te tokes, rritjes dhe ruajtjes se pjellorise se saj. Vetem duke njohur vecorite e plehrave dhe objektin e lendes se ushqimit te bimeve bujqesore mund te plotesohen nevojat e bimeve si nga rezervat e tokes ashtu dhe nga pleherat organike dhe kimike, qe perdoren ne toke ose direkt mbi bimet.

Pleherat kimike ne Shqiperi filluan te perdoren me ndertimin e uzines se azotikut ne Fier dhe superfosfatit ne Lac. Perdorimi I pleherave I hap rruge perspektives se zhvillimit te bujqesise intensive me rreth perdorimin e 100 mije ton pleherave azotike e fosfatike. Krahas pleherave minerale rendesi te vecante duhet ti kushtojme pleherave organike rendesia e te cilave jo vetem eshte e padiskutueshme por me vlere te shumeaneshme per token dhe bimet bujqesore.

Klasifikimi I pleherave

Pleherat klasifikohen ne disa menyra bazuar ne kriter te tilla sic jane prejardhja, sipas veprimit, permbajtjes dhe perberjes se tyre. Ne baze te perberjes I ndajme ne plehera organike dhe minerale; ne baze te permbajtjes i kemi te thjeshte dhe komplekse per ushqimin e bimes; ne baze te prejardhjes se tyre pleherat mund ti ndajme ne plehera natyrale(plehu I stalles,torfa, gelqeroret dhe plehera artificiale (pleherat industriale ose kimike).

Pleherat kimike azotike

Pleherat kimike azotike ndahen ne kater grupe: nitratike, amoniakale, nitratike-amoniakale dhe amide.

Ne grupin e pleherave nitratike hujne salitra e kilit, nitrati I kalciumit, nitrati I kaliumit. Ne grupin e pleherave amoniakale perfshihen disa lloje sic jane: amoniaku I anhidruar, ujrata amoniakale, tretesirat e azotit, sulfati I amonit, kloruri I amonit etj. Ne pleherat nitratike amoniakale ka perdorim shume te gjere ne bujqesi nitrati I amonit, I cili eshte prodhuar ne Uzinen e Azotikut ne Fier. **Nitrati I amonit eshte pleh me natyre kristalore me ngjyre te bardhe ne te verdhe dhe permban 33-35% azot.** Ne pleherat azotike amide me te perhapur jane ureja dhe cianamida e kalciumit, ureja eshte prodhuar ne Uzinen e azotikut ne Fier. **Ureja permban 46% azot,** ka ngjyre te bardhe dhe nuk eshte shperthyes. Eshte pak higroskopik gje qe lehteson shperndarjen me mjete mekanike dhe perzierjen me plehera te tjere. Kimikisht eshte lende organike, por per shkak te veprimit te saj ne ushqimin e bimeve perfshihet ne pleherat minerale.

Pleherat kimike me permbajtje fosfori

Prodhen nga perpunimi I fosforiteve dhe apatiteve. Klasifikohen duke u bazuar ne baze te tretshmerise se tyre ne uje, te menyres se prodhimit dhe permbajtjes se acidit fosforik. Perfaqesuesit me kryesore te ketyre pleherave jane superfosfati dhe superfosfati I perqendruar.

Superfosfati, paraqitet me ngjyre gri, pluhur ose I granular, pjeserisht I treteshme ne uje. **Permbajtja e P₂O₅ ne superfosfat leviz 14-20%.** Ne se gjate prodhimit te superfosfatit e trajtojme ate me acid sulfurik dhe acid fosforik do te prodhohet **superfosfati me 20-30% P₂O₅.**

Pleherat kimike me permbajtje kaliumi

Pleherat me permbajtje kaliumi ne forme K₂O prodhen nga burime te ndryshme qe permbajne kalium sic eshte uji I detit dhe nga terrene qe dikur kane gene detra. Kriperat me permbajtje kaliumi mund te jene natyrore ose te prodhimit industrial.

Kriperat e kaliumit natyrale jane: silviniti, kainite, karnaliti dhe kriprat e forta te perziera.

Kriperat industriale te kaliumit me te perhapura jane kloruri I kaliumit, sulfati I kaliumit, sulfati I kaliumit dhe magnezit etj.

Mikropleherat dhe llojet e tyre

Pleherat minerale te prodhuara ne menyre industriale permbajne sasira te vogla mikroelementesh dhe kjo ben qe bimet te sigurojne vtem pjeserisht nevojat e tyre biologjike. Kjo ben qe prodhimi I mikropleherave sot ne bote, per kushtet e nje bujqesie te zhvilluar, te jete nje domozdoshmeri. Zhvillimi intensive I bujqesise kerkon qe mikropleherat te inkuadrohen ne radhen e pleherave te tjere kimike per pleherimin e bimeve bujqesore. Kjo ka bere qe sasia dhe llojet e mikropleherave te vine duke u shtuar. Mikropleherat qe prodhohen dhe perdoren me gjeresisht jane ato te borit, manganit, bakrit, zinkut, molibdenit dhe helatet e ndryshme.

Mikropleherat e borit:

Boraksi qe permban 11% bor te paste ose 36.5% ne formen e oksidit te borit. Per hardhine rezultate te mira jep doza 10 kg/ha ndersa per mollen 0.3-1.0 kg/ha. Mielli I borit permban 2-2.5% bor, per pleherim baze rekomandohet ne dozen 50 kg/ha dhe per pleherim plotesue 10-12 kg/ha. Te tjere mund te permendim superfosfatin e borit, termoborate dhe precipitate I borit dhe manganit.

Mikropleherat e manganit:

Ketu mund te permendim sulfatin e manganit qe permban 26% mangan dhe 15% sqfur; superfosfati I manganizuar qe permban 1.5-22.5% mangan; manganali qe permban 21% mangan; tomas fosfati qe eshte nje pleh me permbajtje kryesisht mangani dhe pjeserisht fosfori etj.

Mikropleherat e bakrit:

Me kryesori eshte sulfati I bakrit $\text{CuSO}_4 \cdot 5\text{H}_2\text{O}$ qe permban 25.9% baker te treteshem ne uje. Jep efek pozitiv ne toke me dozen 10-25 kg/ha por edhe si pleherim gjethor ne dozen 300-600 lit/ha ose 0.02-0.05%. Me pas mund te permendim miellin e bakrit qe prodhohet nga mbeturinat e industries se perpunimit te xeheroreve te bakrit dhe qe eshte me veprim shume te ngadalshem, per kete arsye rekomandohet te perdoret ne doza te medha deri ne 900 kg/ha.

Mikropleherat e zinkut:

Me kryesori eshte sulfati I zinkut $\text{ZnSO}_4 \cdot 7\text{H}_2\text{O}$, pluhur I bardhe I treteshme ne uje dhe qe nuk eshte higroskopik, permban 22.8% zink. Perdoret nepermjet tokes ne dozen 5-10-25 kg/ha dhe pleherim gjethor ne dozen 0.15-0.20% gjate vegjetacionit

Mikropleherat e molibdenit:

Molibdati I amonit qe permban 50% molibden te treteshem ne uje. Perdoren me anen e tokes ne dozen 2.8 kg/ha, ndersa nepermjet gjetheve me koncentrimin 0.3-0.5% ose 1.8- 3.0 kg/600 litra uje/ha. Superfosfati I molibdenizuar qe permban 0.2% molibden, jep rezultate te mire vecanerisht ne toka acide.

Pleherat e perziera

Pleherat e perziera perftohen nga perzierja e thjeshte ne rruge mekanike e pleherave te vecante. Ne pleherat e perziera me te rendesishem jane: Kombinimet azot-fosfor, azot-fosfor-potas, fosfor-potas, azot-potas etj.

Pleherat komplekse

Pleherat komplekse janë homogjene pasi në çdo granul të tij gjendet të gjithë komponentet përberes të tij. Përbehen nga komponentet azotike, fosfatike e potasike.

Ketu mund të përmendim si më të rëndësishëm plehun amofos (M.A.P) dhe diamofos (D.A.P). MAP përmban 11-12% azot dhe 52% fosfor, ndërsa DAP përmban 16-18% azot dhe 46% fosfor.

MAP (monoamoniumfosfat) ka formulë, $\text{NH}_4\text{H}_2\text{PO}_4$.

DAP (diamonfosfat) ka formulë, $(\text{NH}_4)_2\text{HPO}_4$.

Duke përdorur 100 kg/ha DAP është e barabartë me përdorimin e 100 kg sulfat amoni dhe 300 kg/ha superfosfat. MAP është më i qendrueshëm se DAP sepse në temperaturën 70 grade DAP çliron amoniakun dhe kalon në formën e MAP.

Të dy janë të tretshëm në ujë. DAP tretet 7 gr/100gr ujë, ndërsa MAP tretet 40.3 gr/100 gr ujë.

Pleherat organike

Më plehera organike do të kuptojmë lëndët, materialet më orgjine bimore e shtazore të fresketa ose të zberthyera me rrugë biologjike të cilat hidhen në tokë për pleherim. Pleherat organike nën veprimin e mikroorganizmave transformohen pjesërisht në humus, icili përben rezervën kryesore, më të rëndësishme të lendeve ushqyese dhe faktorin kryesor të përmirësimit të vetive të tokës. Përdorimi i pleherave kimike me ato organike rrit sasinë e përgjithëshme të mikroorganizmave në tokë, ndërsa përdorimi tyre i pa kombinuar me pleherat organike shkakton prishjen e strukturës dhe ul aktivitetin e mikroorganizmave në tokë.

Nga pleherat organike më të rëndësishëm janë plehu i stalles, lengu i plehut, fekalet, torfi, plehu i shpendeve, humusi i pullit, kompostot, mbeturinat e të fshirat e qyteteve etj.

Nepërmjet pleherimit organik kryesisht në tokë sigurojmë në sasinë më të mëdha elementin e azotit, potasit, prandaj edhe efekti më i madh është në ato bimë që i kërkojnë më shumë këta elemente siç janë misri, panxharsheqeri, patatja, luledielli e perimet të cilat ciklin e rritjes dhe zhvillimit e kalojnë në kohën më të ngrohtë të vitit. Sasia e përdorimit të plehut organik është në varesë të faktorëve të tillë si shkalla e kalbjes së tij, kërkesat e bimes, pjelloria e tokës, kushtet klimatike tokësore etj.

Prodhuesit kryesorë në vend

Prodhimi në vend i pleherave kimike me azot e fosfor në vendin tone filloi në vitin 1967, më ngritjen e Uzines së superfosfatit në Lac dhe të uzines së Azotikut në Fier. Në vitin 1982 sasia e pleht fosfatik ishte 1.5 here më e lartë se në 1970 dhe 1.3 here në krahasim me vitin 1975, ndërsa nitrati i amonit i prodhuar në vitin 1982 ishte 1.4 here më i lartë se në 1970. Si nënprodukt i përpunimit të gazit të koksit pranë Kombinatit Metalurgjik Elbasan si dhe pranë kombinatit të përpunimit të thellë të naftës në Ballsh prodhohej sulfati i amonit.

Në tabelën e mëposhteme po paraqesim sasinë e pleherave kimike azotike e fosfatike të prodhuara gjatë viteve 1985-1992.

Sasite e prodhuara ne vend

Prodhimi I plehrave kimike per vitet 1985-1992 (Ne rang Republike)

Nr.	EMERTIMI	VITET								Njesia matese
		1985	1986	1987	1988	1989	1990	1991	1992	
1.	Pleh fosfatik	157	167	174	165	165	141	43	22	000/Ton
2.	Nitrat Amoni	94	110	102	96	109	93	27	9	000/Ton
3.	Ure	77	92	73	77	92	90	28	19	000/Ton

Duhet theksuar se statistikat jane per vitet e mesiperme dhe ne vitet e tjera ka nje mungese te dhenash kjo dhe per aresyen e nderprerjes se prodhimit ne vend te plehrave per shkaqe te ndryshme nder te cilat do te veconim kolapsin e ekonomise si rezultat i ndryshimeve te medha ekonomike ne vend. Reth viteve 1997-2000 nje shoqeri franceze Evertrade e cila ka patur nje histori ne furnizimin e vendit tone me lende te para fosfatike u perpoq ta merte me koncesion uzinen e Lacit dhe prodhoj aty reth 15 mije ton plehra me lende te para stok dhe te importuara si dhe acid qe merrte nga maqedonia por ky prodhim nuk zgjati me per konflikte te ndryshme.


Aktualisht prodhimi vendas eshte zero persa i perket plehrave kimike. Per plehrat massive, Nitrat, Ure, Superfosfat DAP prespektiva eshte qe ato te mos prodhohen me ne shqiperi ndersa per plehrat e kombinuara prodhimi i tyre do te zhvillohet ne shqiperi. Keshtu shoqeria Agrobland ne nje Siperfaqe prej 1.1 Ha dhe ne nje ndertim prej 900 M2 do te ndertoje nje linje per prodhimin e plehrave NPK kristalore. Ky investim ka per qellim qe prodhim i pare te jete ne fund te ketij viti. Kapaciteti i linjes do te jete 20 Ton ne ore. Me kete linje kjo kompani synon qe te zere te pakten 50%te tregut si vit te pare dhe duke u zgjeruar ne vitet ne vazhdim. Gjithashtu ajo synon qe me kete prodhim te zevendesot nje sasi e plehrave massive me ato te kombinuara.

Sasite e importuara ne 3 vitet e fundit, firmat importuese

Sasite e importuara ne vite ne ton ne lidhje me kategorite e permendura me siper jane:

Emertimi	2004	2003	2002
Plehra Azotike	50.000	40.000	50.000
Ure	25.000	20.000	25.000
Nitrat	25.000	20.000	25.000
Plehra Fosfatike	30.000	30.000	20.000
Pluhur	15.000	15.000	10.000
Granular	15.000	15.000	10.000
DAP	12.000	8.000	10.000
NPK	500	300	200
Plehra Potasike	400	400	300
Plehra Kristaline	1000	400	100
Plehrat gjethore	1		
TOTAL	93,900	79,100	80,700

Shenim: Ne kete Tabele nuk jane future ne kalkulim plehrat e importura nga granti Japonese.



Gjithsejt ne vendin tone importohen reth 200 Tone Pesticide ne vit. Aktualisht pesticidet, referuar edhe sasive te vogla te perdorimit te tyre, i kane importuar subjekte te ndryshme dhe nga vende te ndryshme.

Menyrat e importit dhe amballazhi.


Importimi i plehrave Azotike realizohet kryesisht me anije 2-3 mije Toneshe dhe



GUARANTEED ANALYSIS	29-3-4	← 1
Total Nitrogen (N)	29.0%	← 2
1.1% Ammoniacal Nitrogen		
5.2% Nitrate Nitrogen		
17.5% Urea Nitrogen*		
Available Phosphate (P ₂ O ₅)	3.0%	← 2
Soluable Potash (K ₂ O)	4.0%	← 2
Total Iron (Fe)	2.0%	← 3
0.02% Water Soluble Iron (Fe)		
Derived From: Polymer-coated Urea,		← 4
Ammoniacal Sulfate, Ammoniacal		
Phosphate, Muriate of Potash.		



nje sasi e vogel vjen me kamiona 25 Tonesh. Amballazhi I tyre eshte me thase polietileni 50 Kg. Plehrat fosfatike edhe keto vijne vetem nga deti me anije te cilat kane nje kapacitet tonazhi rreth 2-3 mije toneshe. Keto lloj pleherash vijne rifuxho dhe te amballazhuara ne thase 50 Kg. Superfosfati pluhur vjen I amballazhuar ne qese plastike ose letre mbeshtjelle me thase plestike po keshtu edhe granulati. DAP vjen ne forme rifuxho edhe ky me anije pak me te vogla 1000-1500 Toneshe dhe amballzhi I tij behet ketu ne thase 30 ose 50 kg nga vete firmat importuese. Plehrat NPK vijne kryesisht me anije por edhe nga toka, ato kane amballazh me thase te mire



plastike te forte dhe ne raste e nevojshme me shtresa mbrojtese nga lageshtia apo dritat e forta (shpesh shikon qese me ngjyre te hapur nga jashte e bardhe dhe te zeza nga brnda). Zakonisht ne nje thes me plehra te kombinuara kemi ne krye te thesit tre shifra qe tregojne permbajtjen e Azotit(N) Fosforit (P) dhe te Potasit (K) si dhe ne figure gjithashtu ne thes eshte e stampuar edhe permbajtja e lamenteve te vecante qe permabn ky loj plehu imik i kmbinuar ne rastin tone Hekuri.



Plehrat potasike vijne me toke dhe jane te ambalazhuar me thase plastike dhe ne sasira te ndryshme. Plehrat Kristaline vijne me toke me kamione te madhesive te ndryshme dhe me amballazhe te tipeve te ndryshme duke filluar nga thaset 5kg deri 50 kg dhe shishe plastike apo voza plastike nga 1kg deri 25 kg.



Cmimet e blerjes nga importi dhe shitjes se plehrave ne vend

Cmimet jane ne lek per 1 kuintal ndersa plehrat gjethore jane leke per 1 Kg

Emertimi	Cmimi Shumices	Cmimi Pakices
<i>Plehra Azotike</i>		
Nitrat	2.300	2.800-3.000
Ure	3.000-3.600	4.000-4.500
<i>Plehra Fosfatike</i>		
Pluhur	1.500	1.600-1.800
Granular	1.600	1.800-2.000
<i>DAP</i>	3.600	4.000-4.200
<i>NPK</i>	3.100-3.400	4.000-4.500
<i>Plehra Potasike</i>		
<i>Plehra Kristaline</i>	5.000-6.000	5.000-6.000
<i>Plehrat gjethore</i>	2.000-3.000	2.000-3.000

Duhet theksuar qe cmimet e plehrave kimike fund vitin e 2004 dhe fillim viti i 2005 jane te rritura referuar krizes energjitike qe ka kapur gjithe ekonomine boterore. Kjo mbasi dihet qe ka nje lidhje shume te ngushte midis gazit natyror qe sherben si lende e pare per prodhimin e plehrave kimike dhe cmimit te naftes ne tregun nderkombetar. Cmimet zakonisht tregetaret i marin FOB dhe paguajne vete navllonine anijes Freight/ton i cili per anijet 2-3mije toneshe eshte 15-20 USD/ton nga portet e mesdheut dhe 20-25 USD/Ton nga Deti i zi. Dogana e ketyre lendeve te para eshte 2% ndersa trajtimi ne port, analizat e mallit, detyrimet e ndryshme fiskale te sherbimit etj etj varijojne nga 6-10 USD/Ton. Ka raste kur merren dhe cmimet CIF vetem se ne keto raste primi i sigurimit (I) eshte pak me i larte se kur e punon vete anijes.

Aktualisht ne kete moment cmimet e produkteve jane

Emertimi	Kushti	Cmimi	Njesia
Nitrati	CIF	190	USD/Ton
URE	CIF	230	USD/Ton
Superfosfat P	FOB (amball)80		USD/Ton
Superfosfat G	FOB (rifuxho)80		USD/Ton
DAP	FOB	260	USD/Ton

Efektiviteti ekonomik i perdorimit te pleherave

Ne kushtet e intesifikimit te bujqesise, perdorimi i pleherave organike dhe kimike eshte nje nga hallkat kryesore per rritjen e shpejte te prodhimit bujqesor. Perdorimi i efektshem i tyre ka qene dhe mbetet nje nga detyrat kryesore te punonjesve te prodhimit bujqesor dhe te institucioneve shkencore perkatese. Kimizimi si faktor i intesifikimit te bujqesise, shoqerohet me rritjen e shpenzimeve te prodhimit per cdo hektar toke, prandaj kerkohet qe keto shpenzime te justifikohen me shtesa sa me te larta te prodhimit bujqesor.

Ne te kaluaren ne vendin tone perdoreshin vetem sasi te kufizuara pleherash

organike, niveli agroteknik ne bujqesine tone ka qene aq i ulet sa qe pleherat kimike dhe pesticidet e ndryshme nuk njiheshin nga fshataret. Perdorim i i tyre ne vendin tone ka filluar mbas clirimit dhe ne menyre te vecante mbas viteve 1966, vit ky ne te cilin jane vene ne funksionim Uzina e prodhimit te superfosfatit ne Lac dhe Uzina e prodhimit te nitrarit te amonit dhe urese ne Fier. Sipas statistikave te ndryshme Bujqesia jone e periudhes se sistemit socialist ka perdorur per cdo vit rreth 6 milione ton plehera organike te kombinuara me mbi 300 mije ton plehera kimike. Kjo gje ka qene e lidhur ngushte edhe me politikat e kohes sipas te cilave duhej qe me cdo kusht te sigurohej buka ne vend, kusht ky qe konsiderohej si nje faktor shume i rendesishem i pavaresise se vendit. Shume shpesh eshte abuzuar shume me kete gje duke rritur shume kostot e prodhimit deri ne ate mase sa te mos justifikohet sasia e perdorimit te pleherave me rritjen e realizuar te prodhimit.

Rritja e efektivitetit te pleherave qe reflektohet ne shtesen e prodhimit per njesi te plehut te perdorur dhe ne koeficientet e shfrytezimit te tyre, mbetet nje nga detyrat kryesore te punonjesve te bujqesise.

Per arritjen e efektivitetit te larte ne perdorimin e pleherave, krahas zbatimit te kodit agroteknik kerkohen dhe njohuri te caktuara agrokimike. Ne radhe te pare, pleherat organike dhe kimike duhet te perdoren ne dozat optimale dhe ne menyre te kombinuara. Per te percaktuar dozat optimale per kultura te ndryshme dhe ne kushte te ndryshme klimatiko-tokesore, duhet te njihen kerkesat e bimeve per lende ushqyese, potencialiteti tokes qe reflektohet ne harta agrokimike, koeficientet e shfrytezimit te lendeve ushqyese te tokes e te pleherave etj. Ne perdorimin e pleherave duhet te kihet parasysh specifika e cdo plehu si dhe kerkesen e bimeve per lenden ushqyese jo vetem globale por edhe sipas fazave te zhvillimit ne menyre qe pleherimi te behet ne kohen dhemenyren e duhur.

Veprimi i pleherave ne permbajtjen dhe cilesine e prodhimit

Kimizimi i bujqesise dhe ne vecanti perdorimi gjeresisht i pleherave eshte faktori kryesor per intesifikimin e prodhimit bujqesor. Llogaritet se jo me pak se gjysma e rritjes se prodhimit bujqesor boteror mund te merret per llogari te perdorimit te pleherave. Te dhenat e prodhimit te gjere dhe te institucioneve shkencore deshmojne per rolin e madh te pleherimit ne rritjen e prodhimit dhe permiresimin e cilesive te tij.

Bima per rritjen dhe zhvillimin e saj ka kerkesa te caktuara ndaj faktoreve te mjedisit te jashtem, faktore keta qe kushtezojne karakterin dhe intemsitetin e proceseve fiziologjike, biologjike qe zhvillohen ne organizmin bimor dhe per pasoje formimin e ledhjeve organike te rendesishme siproteinat, yndyrnat amidonet, sheqernat vitaminat si dhe lende te tjera qe karakterizojne cilesine e prodhimit.

Permiresimi i kushteve te kultivimit te bimeve shkakton ndryshime te theksuara si ne madhesine ashtu dhe ne cilesine e prodhimit. Pleherimi konsiderohet si faktor kryesor dhe me veprim te shpejte qe ndikon ne kete aspekt. Permiresimi i regjimit ushqimor favorizon ne menyre te ndjeshme grumbullimin ne organet e bimes te substancave te dobishme per organizmin e njeriut e te kafsheve. Perdorimi gjeresisht i pleherave e me kritere shkencore permireson permbajtjen e makro dhe mikro elementeve te aminoacideve te pazevendesushem per jeten e organizmave shtazore si dhe te vitaminave ne produktet bujqesore qe perdoren

per ushqimin e tyre. Mungesa ose pamjaftushmeria e tyre shkakton keqesimin e aktivitetit jetesor te organizmit ul imunitetin e qendrueshmerine e tyre dhe shton cfaqjen e semundjeve te ndryshme fiziologjike gje qe lidhet dirket me nivelin e produktivitetit te bashkesive bimore. Por njekohesisht perdorimi i rastesishem i pleherave pa marre parasysh vecantite biologjike te kulturave dhe kushtet pedoklimatike nuk jep efektin e duhur dhe mund te keqesohen cilesite e prodhimit.

Keshtu mund te theksojme se perdorimi me doza te pershtateshme te azotit ne rastin e kultures se grurit, ka veprim te sukseseshem ne rritjen e rendimentit dhe cilesine e prodhimit. Ne kokrrat e grurit rritet permbajtaja e lendeve proteinike dhe ne pergjithesi permiresohen treguesit morfologjike si forma e kokrres, madhesia e saj, ngjyra dhe kristaliteti i kokres dhe tregues te tjere qe percaktojne cilesine teknologjike per prodhimin e bukes.

Ndikimi i pleherimit ne cilesine e prodhimit percaktohet nga gjendja e pjellorise se tokes, lloji i plehut, doza, koha dhe menyra e perdorimit te tyre. Ne pergjithesi pleherimi azotik rrit permbajtjen e lendeve proteinike, kurse fosfori, potasi shtojne permbajtjen e sheqernave dhe te yndyrnave. Tek bimet vajore si psh. luledielli eshte konstatuar se nga perdorimii bollshem azotik permbajtaja e vajit ka rrene nga 54 ne 39%. Por megjithese mund te shkaktohet ulja e perqindjes se vajit, ne saje te rritjes se rendimentit shpie ne rritjen e sasise se pergjitheshme te vajit per ha. Per kete arsye pleherimi azotik eshte i nevojshem edhe per kulturat vajore. Per kete kultre shtesa me e larte e vajit ne ketokushte eshte arritur ne saje te pleherimit fosfatik e potasik ne prani te permbajtes optimale te azotit. Perdorimi i njeanshem i tyre keqeson cilesine e prodhimit. Perdorimi i kombinuar i pleherave organike me pleherat kimike duke perfshire si makro dhe mikroelementet eshte nje faktor tjetere qe permireson shkallen e shfrytezimit te tyre dhe rriten vlerat ushqyese te produkteve bujqesore. Ne pergjithesi pleherimi racional i kulturave industriale si pambuk, panxhar sheqeri, duhan etj. I perimeve foragjere etj., rrit vlerat ushqyese e teknologjike te tyre. Te pambuku permiresohet fortesia e fijos, gjatesia e trashesia e saj. Cilesia e duhanit percaktohet nga nje mase e konsiderushme te permbajtjes ne te sheqernave dhe proteinave. Pleherimime doza dhe raportioptimalmidis azotit, fosforit dhe potasit ndikon pozitivisht ne permbajtjen e tyre, perqindjes se nikotines, substancave aromatike, ngjyrene e gjetheve etj. Pleherimi fosfatik pakeson sasine e proteinave, te nikotines dhe azotin e pergjitheshem. Potasi rrit permbajtjen e sheqernave dhe permireson shkallen e djegshmerise gjte pirjes se duhanit. Shume i rekomandushem eshte perdorimi i potases edhe ne rastin e pleherimit te hardhive dhe patateve. Roli i pleherave ne cilesine e prodhimit eshte imadh ne tokat me ujitje. Keshtu te perimet rritet permbajtja e lendes se thate, e sheqernave, kriprave minerale, vitaminave etj.

Te dhenat tregojne se me perdorimin e drejte te pleherave duke marre parasysh kushtet klimatike e tokesore e vecorite biologjike te bimeve sigurohen rendimente te larta e te qendrushme dhe cilesi e mire e prodhimit.

Kimizimi i bujqesise dhe perdorimi intensiv i pleherave kimike ka sherbyer si nje leve e fuqishme per rritjen progresive te pjellorise se tokes e mbi kete baze per rritjen e rendimenteve te kulturave bujqesore dhe per permiresimin e cilesise tyre. Por ne keto kushte eshte me se e nevojeshme ruajtja e mjedisit nga ndotjet qe shkaktohen prej tyre dhe vecanerisht prej nitrateve dhe mbetjeve te tjera

kimike te demeshme per shendetin e njeriut dhe te kafsheve.

Pleherat minerale, kryesisht atofosfatike dhe disa plehera komplekse permbajne ne forme perzierjesh elemente radioaktive ose me efekt toksik, psh. permbajne kadmium ne fosforitet qe nxirren nga vendburimet e pasura te Marokut (mesatarisht 12 mgr/kg), te Algjerise (23 mgr/kg), Tunizise (56 mgr/kg) etj.

Te dhena studimore bashkekohore deshmojne se prej pleherave kimike azotike nga shplarja e nitrateve ndoten ujrat e pishem e ne kushte te caktuara nitratet mund te grumbullohen ne produktet bimore te cilat kane veprim toksik per jeten e njeriut e te kafsheve. Per kete arsye kujdes te posacem duhet ti kushtohet nga ana agrokimike dozave te pleherimit azotik po keshtu te diagnostikohet permbajtja e tyre ne produktet bujqesore. Ndotja e mjedisit shkaktohet nga perdorimi i dozave te larta e te pa bazuara te pleherave azotike, pleherimit te disballancuar ndermjet pleherave kryesore azotike, fosfatike e potasike, ne pershtatje me cilesite e tokes, kerkesat biologjike te kulturave etj.

Perdorimi i kombinuar i pleherave organike me ato minerale, i dozave dhe raporteve te drejta, koha e perdorimit, perdorimi i lokalizuar i pleherave azotike dhe frenuese te nitrifikimit etj, etj. Krijojne premisa per rritjen e prodhimit bujqesor dhe pakesimin e rrezikut te ndotjes se mjedisit nga mbetjet e kimikateve te ndryshme qe perdoren ne bujqesi.

Sistemi i perdorimit te pleherave ne kulturat e ndryshme bujqesore

Ne kete pjese do te flasim shkurtimisht per perdorimin e pleherimit ne disa lloje te lashtash kryesore , ne perime , ne patate, foragjere si dhe ne disa lloje dru frutoresh. Kryesisht do te ndalemi ne nevojën e tyre per lloje te ndryshme pleherash kimike si dhe per normat e perdorimit te tyre. Sigurisht qe per kete kemi patur parasysh gjendjen dhe perspektivat e zhvillimit te bujqesise se vendit tone. Nuk do te ndalemi gjate ne nevojën e pleherimit me plehera te ndryshme organike.

Pleherimi i grurit

Sipas statistikave te MBU, siperfaqja e mbjelle me grure ne vendin tone per vitin 2003 ka qene 90,800 hektare pra rreth 23% e siprfaqes se pergjitheshme te mbjelle. Shifrat tregojne se kjo siperfaqe ka pesuar nje ulje te lehte nga viti ne vit.

Pleherimi i grurit me kritere te drejta shkencore perben nje nga hallkat me te rendesishme per marrjen e rendimenteve te larta. Gruri reagon shume ndaj pleherimit azotik, ndaj mungeses se fosforit dhe ne nje fare niveli edhe ndaj potasit sidomos per tokat e varfera ne kalium.

Efekt i azotit ndjehet ne zhvillimin e mases vegjetative, ne organet e riprodhimit ne peshen e kokrrave dhe ne cilesine e prodhimit. Te ushqyerit e grurit me azot, luan rol te rendesishem ne sintezen e proteinave dhe rritjen e permbajtjes se glutenit. Por duhet patur parasysh qe perdorimi i dozave te larta te azotit rrit tej mases pjesen vegjetative te bimes, dukuri kjo qe i ben bimet te jene te predispozuara per tu rrezuar dhe me te ndjeshme per tu prekur nga semundjet bakteriale dhe kerpudhore.

Efekt i fosforit paraqitet vendimtar ne fazat e para te rritjes se grurit, gje qe kerkon patjeter pranine e tij ne formen e superfosfatit edhe per shkak te aftesise

se dobet te sistemit te tij rrenjor per te pervesuar fosfor nga toka. Nje dukuri i tille kerkon qe nje pjese e pleherave fosfatike te perdoret sebashku me faren. Elementi i fosforit ne bime ndikon ne sintezen e nje sere kompleksesh organike, rrit numurin e kokrrave, shton formimin e organeve te riprodhimit, energjine e vellazerimit, rrit qendrusherine e bimeve ndaj semundjeve, rrezimit, temperaturave te ulta etj. Ai ndikon pozitivisht ne avancimin e pjekjesduke shkurtuar fazene rritjes e te zhvillimit te bimes.

Kerkesat ndaj kaliumit jane po aq te domozdoshme sa edhe ndaj azotit e fosforit. Ai ndikon pozitivisht ne rritjen e rezistences se bimeve ndaj temperaturave te ulta dhe semundjeve bakteriale e kerpudhore.

Ne perdorimin e pleherave minerale per pleherimin e grurit rendesi te madhe kane raportet ndermjet azotit e fosforit. Kombinimi midis tyre varet nga nevoja biologjike, gjendja e elementeve ne toke dhe shkalla e shfrytezimit dhe pervesimit te tyre. Te dhenat e shume provave eksperimentale vertetojne se raporti i azotit me fosforin ne tokat e pasura me fosfor eshte 1:0.3, ne tokat e mesme 1:0.6 dhe ne tokat e varfera 1:1. Keto raporte jo vetem qe garantojne te ushqyerit optimal te bimeve te grurit per marrjen e rendimenteve te larta por garantohet edhe rezerva e fosforit ne toke qe sherben si baze e rritjes se pjellorise se tokes. Shembuj te ndryshem te rendimenteve te larta te grurit flasin per doza pleherimi me 3-3.5 kv/ha nitrat amoni ose 2.6-3.3 kv/ha ure dhe 2.5-3 kv/ha superfosfat.

Perdorimi i mikroelementeve te tille si zink, mangan dhe boraks (15 kg sulfat zinku/ha), ndikon pozitivisht ne rritjen e rendimentit te grurit dhe cilesise tij.

Pleherimi i misrit

Sipas statistikave te MBU, sipërfaqja e mbjelle me mizer ne vendin tone per vitin 2003 ka qene 48,300 hektare pra rreth 12% e sipërfaqes se pergjitheshme te mbjelle. Shifrat tregojne se kjo sipërfaqe ka pesuar nje ulje te lehte nga viti ne vit.

Per kulturen e misrit, krahas perdorimit te pleherave organike nje vend te rendesishem zene edhe pleherat kimike. Kerkesat e medha te misrit per lende ushqyese bejne te domozdoshem kerkesen per plehera organike dhe minerale. Ai reagon mire ndaj pleherimit dhe i shfrytezon ato me intensitet me te larte se gruri dhe te lashtat e tjera.

Misri njihet si bime azot-dashese. Azoti ndikon jo vetem ne shtimin e prodhimit, por edhe ne permiresimin e cilesive teknologjike te misrit, si ne rritjen e permbajtjes se rrezines, lizines, globulines etj. Kerkesat per azot jane te shumta qysh ne periudhen e pare te rritjes se misrit. Te dhenat eksperimentale tregojne se ne sfondin e pleherave fosfatike e potasike per marrjen e rendimenteve te larta duhen perdorur dozat 150-180 kg/halende vepruese azot. Pleherat azotike perdoren ne pleherimin baze dhe ate plotesues.

Pleherat azotike perdoren te kombinuara me ato fosfatike. Pleherat fosfatike ne mizer perdoren ne pleherimin baze para punimit te fundit te tokes. Studimet tregojne se per marrjen e rendimenteve te larta nemiser, ne sfondin e azotit dhe potasit duhen perdorur 80-130 kg/ha lende vepruese fosfor.

Ne kushtet e perdorimit te dozave te larta te azotit e fosforit per marrjen e rendimenteve te larta eshte e nevojeshme qe te perdoren edhe plehera potasike qe zakonisht rekomandohen te rendit 40-65 kg/ha lende vepruese potas. Ne

rastin e pleherimit te lokalizuar (perdorimi ne fole) rekomandohen dozat 150-200 kv/ha pleh organik, 5-6 kv/ha superfosfat dhe 1 kv/ha nitrat ose ure.

Te dhenat eksperimentale tregojne se perdorimi i mikroelementeve te tille mangan, zink, bor etj. ndikojne mjaft ne rritjen e rendimentit

Pleherimi i patates

Sipas statistikave te MBU, sipërfaqja e mbjelle me patate ne vendin tone per vitin 2003 ka qene 10,500 hektare pra rreth 2.6% e sipërfaqes se pergjitheshme te mbjelle. Shifrat tregojne se kjo sipërfaqe pothuajse nukka pesuar ndryshimete theksuara gjate ketyre viteve te fundit. .

Patatja ze nje vend te konsiderushem ne ushqimin e perditeshem. Ajoperdoret ne pergatitjen e nje sere asortimentesh konsumi. Ajobem pjese ne grupin e bimeve potas-dashese, per sintezen e nje ton prodhimi duhen 5 kg azot, 2 kg fosfor dhe 14 kg potas. Ato i duhen plotesuar bimes ne raporte te caktuara per te ndikuar ne rritjen dhe zhvillimin normal te tyre.

Elementi i azotit ndikon ne sintezen e aminoacideve, proteinave dhe rritjen e permbajtjes se lendes organike. Fosfori merr pjese ne sintezen e amidonit, shkurton fazat e rritjes se bimeve, fuqizon sistemin rrenjor dhe rrit qendrushmerine ndaj semundjeve dhe faktoreve te disfavorshem klimatik. Efekti i potasis ndjehet ne rritjen e qendrushmerise se bimes dhe ne formimin e amidonit.

Studimet e kryera dhe eksperiencia e grumbulluar ne fushen e kultivimit te patates tregojne se per te realizuar rendimente te larta nevoiten 150-200 kv/ha pleh organik te kombinuar me 2 kv nitrat, 1-2 kv superfosfat dhe 1-1.5 kv sulfat potasi.

Pleherimi i perimeve ne fushe

Ne kushtet e prodhimit intensiv te kulturave perimore, perdorimi gjeresisht i pleherave organike dhe kimike perben nje faktor teper te rendesishem. Ato rrisin ne menyre te ndjeshme prodhimin dhe permiresojne cilesine e tij duke rritur permbajtjen e sheqernave, amidonit, proteinave, kriperave minerale e vitaminave etj. lende ushqyese keto shume te vlefshme per te ushqyerit dhe shendetin e njeriut. Ne dallim nga bimete e tjera sistemi rrenjor i tyre eshte me pak i zhvilluar dhe me aftesi asimiluese te reduktuar, si rrjedhim mund te themi se bimes i duhet siguruar nje regjim ushqimor i bollshem me lende ushqyese dhe ne forma lehtesisht te asimilueshme.

Pjesa kryesore e perimeve konsumohen ne gjendje te fresket, por aktualisht ne saje te perdorimit te dozave te larta te pleherave azotike e sidomos gjte kultivimit te tyre ne sera, lindin mjaft shqetesime ne drejtim te rritjes se permbajtjes se nitrateve. Percaktimi i dozës, menyres dhe kohes se perdorimit te pleherave azotike perben nje aspekt tjetër te posacem te pleherimit te perimeve qe duhet patur shume parasysh.

Pleherat organike zene vendin kryesor ne sistemin e pleherimit te kulturave perimore dhe konsiderohen te pa zevendesushme, zakonisht tek perimet perdoren doza te larta plehu organik, ne kushtet e kultivimit te perimeve ne fushe

perdoren rreth 400-500 kg/ha pleh organik. Plehu organik perdoret kryesisht ne pleherimin baze para plugmit te tokes, por ato perdoren edhe gjate mbjelljes ne pergatitjen e gropave ne brazda etj.

Per plotesimin e kerkesave te theksuara te perimeve me lende ushqyese, lind nevoja e perdorimit dhe te pleherave kimike me permbajtjete te makro e mikroelementeve te caktuar. Ato duke qene ne forme lehtesisht te treteshme pervehtesohen me lehte qysh ne fazen e pare te rritjes se bimeve. Pra favorizojne zhvillimin e shpejte te sistemit rrenjor dhe te krejt bimes. Perdorimi i tyre ne sasi dhe raporte me kerkesat e bimes eshte nje problem mjaft delikat sepse si mungesa edhe teprica e tyre pengojne zhvillimin e bimes dhe kompromentojne rende prodhimin. Pleherat kimike shperndahen ne pleherimin baze para mbjelljes, ne mbjellje (ne gropa ose brazda) dhe ne pleherimn plotesues.

Pleherimi i domates se fushes

Domatja ka kerkesa te shumta per elemente ushqyese, por ne menyre te vecante per azot, fosfor, potas e kalcium. Pleherat organike, potasike dhe pjesa tjetere e superfosfatit hidhet ne pleherimin baze, ndersa pleherat azotike ne pleherimin plotesues dhe pjeserisht ne punimin pergatitor te tokes. Pleherimi i pare plotesues kryhet me prashitjen e pare ku mund te perdoret rreth 0.3-0.5 kv/ha nitrat amoni, 0.9-1.5 kv/ha superfosfat dhe 0.3-0.4 kv/ha sulfat potasi. Mund te kryhen 2-3 pleherime plotesuese me 10-15 dite njeri pas tjetrit.

Mikroelementet perdoren ne sperkatjen e bimeve me tretesira 0.005 – 0.01% ne periudhen e lulezimit dhe te lidhjes se frutave.

Pleherimi i specit ne fushe

Edhe speci ka kerkesa te theksuara per lende ushqyese, kerkon toka te pasura me lende organike. Reagon mire ndaj pleherave organike te kalbura mire si dhe ndaj pleherave kimike. Speci eshte i ndjeshem ndaj rritjes se perqendrimit te kriperave, prandaj dozat e larte te pleherimit duhet te shoqerohen me ujitje dhe prashitje te shpeshta. Sipas pjellorise se tokes dhe rendimentit te planifikuar perdoret rreth 60 – 90 kg/ha azot, 90 – 100 kg/ha P₂O₅ dhe 40 – 60 kg/ha K₂O. Kerkesat me te medha per azot cfaqen ne periudhen e lulezimit dhe pjekjes se frutave, ndersa periudha kritike e nevojave per potas eshte nga lidhja e frutave deri ne pjekjen e tyre. Bima e specit ka kerkesa te shumta edhe per kalcium dhe mangan dhe reagon mire ndaj pranise se mjaft mikroelementeve ne toke si bori, mangani, zinku, jodi, molibdeni etj.

Pleherimi i trangullit te fushes

Eshte nje nga kulturat me te ndjeshme ndaj rritjes se perqendrimit te kriprave ne tretetesiren e tokes. Ne periudhen e lulezimit dhe frutifikimit asimilohet mese gjysma e sasise maksimale te nevojave biologjike te bimes. Keto vecori bejne qe trangulli te kete kerkesa te medha per lende ushqyese. Ne 10-15 ditet e para bima ka nevojte vecanerisht per azot, pastaj pare fillimit te lulezimit per fosforin dhe ne kohen e frutifikimit per azot dhe potas. Plehu organik mund te perdoret

para punimit te tokes apo ne lokalizim ne gropa gjate mbjelljes. Gjysma e dozës se fosforit dhe potases keshillohet te perdoret ne periudhat pergatitore te tokes, dhe gjysma tjetër ne prashitje sebashku me azotin. Pleherimet e tjera plotesuese me azot behen cdo 10-14 dite.

Pleherimi i shalqinit ne fushe.

Pleherimi racionalme plehera organike e kimike rrit ne menyre te theksuar prodhimine kesaj kulture. Azoti favorizon rritjen e sistemit gjethor dhe zgjat periudhen e lilezimit e te pjekjes, preferon si format amoniakale ashtu edhe ato te nitrateve. Pleherimi fosfatik e potasik shpejton pjekjen dhe rrit permbajtjen e sheqerit ne kokrrat e shalqinit. Efekti i pleherave percaktohet nga afati i perdorimit te tyre. Perdoren ne pleherimin baze, ne periudhen e mbjelljes, ne grope ose ne brazde si dhe ne pleherimin plotesues gjate vegjetacionit te bimes.

Ne pleherimin baze rekomandohen 100-120 kv pleh organik i shoqeruar me 1.5-2 kv/ha superfosfat dhe 1.5 kv/ha pleh potasik. Ne kohen e mbjelljes ne oxhak perdoret nje sasi plehu organik ikalbur mire si dhe 0.5 kv/ha nitrat amoni, 1-1.5 kv/ha superfosfat dhe 1 kv/ha pleh potasik.

Pleherimi i perimeve ne mjedise te mbrojtura (sera)

Ne ambientet e serave veprojne kushte specifike te drejtura temperature, lageshtie, ajrimi etj. Edhe pleherimi ka vecorite e veta specifike ne krahasim me kulturat e mbjella ne fushat e pa mbrojtura. Ne serat kerkohen rendimente te larta, prandaj dozat be pleherimit gjithmone jane me te bolleshme se ato qe rekomandohen per pleherimin e kulturave perimore qe mbillen ne fushe. Rritja dhe zhvillimi i ketyre kulturave ne dritezimte kufizuar ben te nevojshem percaktimin e nje raporti ndermjet elementeve kryesore ne pershtatje me keto vecori. Ne kete rast pleherat perdoren me shume duar gjate gjate gjithë vegjetacionit.

Duhet patur gjithmone parasysh se perdorimi i dozave te larta te pleherave organike dhe azotike ne sera krijon rrezikun e rritjes se nitrateve ne produktet bimore. Per kete arsye rendesi ka lloji i plehut azotik, koha dhe menyra e pleherimit. Psh. per pleherimine sallates dhe spinaqit duhet preferuar ureja dhe jo nitrati i amonit, keto plehera duhet te perdoren ne menyre te lokalizuar dhe jo me shperndarje ne te gjithë siperfaqen etj.

Pleherimi i domates ne sere

Realizimi i rendimeteve te larta ne kushtet e kultivimit ne sere, kerkon qe te zbatohet nje pleherim i bollshem organiko-mineral duke ruajtur njepereqendrim optimal te elementeve te ndryshem ushqimore te tretesires tokesore. Mungesa apo teprica e njerit ose tjetrit element shkakton crregullime ne metabolizmin e bimes dhe pasqyrohet ne sasine dhe cilesine e prodhimit. Keshtu teprica e azotit shkakton rrezimin e luleve, shton masen vegjetative, vonon pjekjen e prodhimit dhe krijon permisa per prekjen nga semundjet. Po keshtu teprica e potasit pengon depertimin e magnezit ne bime. Duhet patur parasysh qe shkalla e pervesimit te lendeve ushqyese ne kushtet e seres zvogelohet ne menyre te konsiderushme gje qe eshte e vlefshme te thuhet si ne rastin e azotit dhe fosforit ashtu edhe te potases, prandaj kerkohet qe permbajtja e ketyre elementeve ne

toke te jete me e larte. Per plotesimin e ketyre kerkesave dhe per faktin se ritmi i mineralizimit te lendes organike ne sera eshte i shpejte per te ruajtur pjellorine e tokes, ne pleherimin e serave perdoren mbi 1000 kv/ha pleh organik.

Keshtu, sipas studimeve te kryera, ne serat me ngrohje te rrethit te Elbasanit eshte arritur nje rendiment i larte (1200 kv/ha domate) duke perdorur 1000 kv/ha pleh organik, 10 kv/ha superfosfat, 10 kv/ha sulfat potasi dhe 10 kv/ha nitrat amoni. Dozat me te larta te N,P,K skane dhene shtese te metejeshme prodhimi dhe kane ndikuar negativisht ne hereshmerine dhe cilesine e prodhimit.

Pleherimi i trangullit ne sere

Gjate kultivimit te trangullit ne sera merren rendimente mjaft te larta, per kete arsye perdoren sasira te konsiderushme te pleherave organike dhe minerale, si ne pleherimin baze ashtu edhe ne pleherimin plotesues gjate vegjetacionit te bimes. Perdorimi i kombinuar i pleherave organike me ato minerale krijone kushte me optimale per furnizimin ritmik te bimes me elemente ushqes ne forme te asimilueshme. Gjithashtu per te siguruar vazhdimesine me lende ushqyese, kerkohet qe te kryhet pleherimi plotesues ne shume duar sebashku me ujitjen gjate vegjetacionit.

Shfrytezimi sistematik i tokave ne sera ben te nevojeshme qe bimes nepermjet pleherimit ti sigurohet krahas makroelementeve edhe mikroelemente te tile si bori, molibdeni, zinku etj. Mikropleherat mund te perdoren me trajtim kubikesh ose me sperkatje gjate vegjetacionit, zakonisht kjomme perqindje te ulta ne varesi te mikroelementit qe perdoret.

Pleherimi I kulturave bishtajore shumevjecare

Kulturat bishtajore shumevjecare perbejne nje pjese te mire te bilancit te foragjereve te blegtorise. Mjafton te permendim se vetem kultura e jonxhes ze rreth 70% te siperfaqe se mbjelle me kultura foragjere. Keto kultura jo vetem qe zgjidhin furnizimin e blegtorise me ushqime, por ato duke qene bime bishtajore pasurojne token me azot e lende organike.

Bimet bishtajore jane shume te ndjeshme ndaj pleherave organike, te cilet ne sistemin e pleherimit te tyre duhet te zene vendin kryesor. Per jonxhen rekomandohet 200-300 kv/ha, ndersa per terfilin 150-200 kv/ha. Keto hidhen ne pleherimin baze, para punimit te tokes. Efekti I pleherave organike rritet 20-30% duke u perdorur I kombinuar me superfosfatin gjate shperndarjes. Pleherat organike te lengshem japin rezultate te dukeshme edhe gjate pleherimit plotesues ne vegjetacion. Nga pleherat kimike rendesi te vecante dhe themelore per marrjen e rendimenteve te larta tek bishtajoret jane pleherat fosforike dhe potasike. Me te efektshme konsiderohen dozat 60-80 kg/ha fosfor dhe 40-60 kg/ha lende vepruese potas. Superfosfati perdoret ne pleherimin baze dhe shoqerues, 15-20% e sasise hidhet ne pleherimin shoqerues sebashku me faren. Pleherat potasike perdoren sebashku me superfosfatin para punimit te fundit te tokes ne pleherimin baze. Pleherat azotike hidhen 20-30% e dozes ose 1 kv/ha ure para diskimit te fundit. Pleherimi plotesues gjate vegjetacionit zakonisht behet me plehera azotike. Pavaresisht se bimet bishtajore 2/3 e nevojave te azotit e fiksojne nga ajri atmosferik, ato kane nevoje per azot sidomos ne periudhen e pare te mbirjes. Me efekt te mire jane dozat 1-1.5 kv/ha nitrat amoni. Ndersa per jonxhen nevojitet heret ne pranvere dhe ne prag te fillimit te dimrit.

Pleherimi I kulturave drufrutore

Pleherimi I pemeve frutore ka vecorite e veta specifike ne krahasim me kulturat nje vjecare, prandaj dhe pleherimi I tyre duhet kryer ne pershtatje me kerkesat biologjike te tyre. Drufrutoret kane kerkesa te shumta per elemente ushqyes qe pervehtesohen nga I njejti vend per nje periudhe kohe (mbi 15-20 vjet). Per marrjen e rendimenteve te larta dhe me cilesi nje rol te posacem tek pemet frutore ka doza e pleherimit dhe raporti midis elementeve ushqyes kryesore. Si mungesa e teprica e tyre pasqyrohet sin e madhesine ashtu dhe ne cilesine e prodhimit.

Pleherimi I ullirit

Ulliri eshte nje kulture me rendesi te madhe ekonomike per vendin tone. Kultivimi tradicional I tij kryesisht perqendrohet ne toka kodrinore te ceketa e me pjellori te kufizuar. Pleherimi, krahas sigurimit te lageshtise se nevojeshme perben faktorin kryesor per permiresimin e gjendjes se pergjitheshme te bimes se ullirit, rritjen e prodhimit dhe zbutjen e periodicitetit te tij. Vendi yne ka mese 4 milione rrenje ullinj me nje siperfaqe toke afersisht 35-40 mije ha, ne toka te pjerreta e me veshtiresi per ujitje.

Ulliri per rritjen dhe zhvillimin normal te tij kerkon nje regjim ushqimor te pershtatshem ku krahas elementeve me kryesore azot, fosfor, potas dhe kalcium duhet ti sigurohen dhe nje sere mikroelementesh si bori, magnezi, mangani etj. Krahas pleherimit organik qe eshte shume I nevojshem qofte per ulla te ekzistuese te vendosura ne zonat kodrinore te tokave te vendit tone te cilat jane te varfera me lende organike dhe kripera minerale ashtu edhe per masivet e reja te ullinjve ne kushte te ujiteshme, eshte I domozdoshem edhe pleherimi me plehera kimike.

Nga studimi kombetar I ullirit, rezultoi se siperfaqet e tokes te mbjella me ullinj paraqiten te varfera dhe mezatarisht te pasura me azot (53.6% te varfera, 40.9% mesatare dhe 5.5% te pasura). Prandaj krahas perdorimit gjeresisht te pleherave organike, **pleherimi azotik** perben faktorin kryesor per krijimin e nje regjimi ushqyes azotik optimal per bimen, me synim qe bimet e reja te fuqizohen e te futen sa me pare ne prodhim, ndersa ato te vjetrat e te zhvilluara dobet te riparterihen e te fuqizohen dhe te sigurohet prodhim I plote. **Per ullinjte ne vitin e pare rekomandohet te perdoret 0.43-0.62 kg nitrat amoni per rrenje dhe per ullinjte ne prodhim doza e nitratit leviz nga 0.68-3.7 kg/rrenje.** Pleherat azotike me te pershtatshem per ullinjte jane si format amoniakale ashtu dhe nitrike.

Krahas azotit eshte I nevojshem dhe pleherimi fosfatik. Persa I perket potasit, per faktin se tokat jane mesatare dhe te pasura me kete element, dhe ne saje te pleherimit organik, ndihet me pak nevoja e perdorimit te tij. **Per ullinjte ne rritje rekomandohet 0.85-0.95 kg/rrenje superfosfat, ndersa per ata ne prodhim jepen doza 0.9-2.95 kg/rrenje.**

Ulliri ka kerkesa te shumta per calcium, prandaj gelqerimi perdoret sin e tokat me aciditet ashtu edhe ne tokat me perberje mekanike te rende. Ne varesi nga permbajtja e kalciumit mund te perdoret sipas mundesive 3-4 kg/rrenje gelqere nje here ne dy tre vjet.

Pleherimi I vreshtit

Vreshtaria ne vendin tone ze nje siperfaqe te konsiderueshme te tokes kundrejt bimeve te tjera frutore. Kjo siperfaqe rritet nga viti ne vit dhe sipas te dhenave statistikore te MBU-se te paraqitura me larte ne vitin 2003 ajo llogaritej ne rreth 7200 ha nga rreth 5060 ha qe ishte ne vitin 1994 (pra me nje rritje prej 42%). Krahas pleherimit me pleh organic ne vitin e pare pas mbjelljes se freshtit bimet e reja kane nevojte kryesisht per azot per zhvillimin e pjeses vegetative te tyre. Sipas gjendjes se azotit ne toke perdoren 0.8-0.9; 0.6-0.7; 0.4-0.5 kv/ha pleh azotik perkatesisht per tokat e varfera, te mesme e te pasura ne azot. Ne vreshta bqe sapo kane hyre ne prodhim perdoren doza relativisht me te larta te pleherimit te plote me azot, fosfor e potas si dhe 350-400 kv/ha pleh organic nje here net re vjet.

Per vreshtat ne prodhim te plote keshillohen si doza te pershtateshme 6-8 kv superfosfat, 1.5-3 kv sulfat potasi dhe 2-3 kv nitrat amoni per hektar; ndersa per cdo rrenje 100-150 gr superfosfat, 30-60 gr sulfat potasi dhe 40-70 gr sulfat amoni.

Potencialet magazinuese ne vend (Numri I magazinave doganore ne vend)

Potencialet magazinuese per plehrat kimike ne vendin tone jane shume me te medha se sa sasia e perdorur nga konsumatorret. Kjo situat e eshte aktualisht e tille mbasi plot ambiente qe ishin parashikuar nga regjimi i meparshem per kete qellim jane trasheguar edhe sot ketu nuk duhet te harrojme faktin qe ne vitin 1989 ne si vend kemi konsumuar reth tre here me teper plehra kimike ne krahasim me ditet e sotme.

Firmat qe importojne sot kane krijuar gjithashtu edhe vendmagazinazhet e tyre per keto produkte. Ne pergjithesi firmat importuese kane magazina te mbuluara por edhe vende me qiell te hapur per stokim te produkteve e importuara. Nje firme e madhe sot ka vend per magazinimi deri ne 5-10 mije ton produkte te tilla neper republike jane reth 4 pika.

Ndersa pikat e distribucionit te plehrave kane aftesite magazinuese deri 100-500 Ton jane reth 80 pika. Ne dyqanet e vegjel aftesia magazinuese vrion nga disa ton deri 50 ton.

III. ANALIZA E KONKURENCES

Analiza swot e tregut te konkurences

Kjo analize do te behet ne formen SWOT (**S**TRENGTH-**W**EAKNESSES-**O**PORTUNITIES-**T**HREATENS) apo sic quhet ndryshe analiza:

Pikat e forta - pikat e dobta - mundesite - kercenimet

Pikat e forta:

- Ka nje numer te kufizuar kompanish qe merren me importimin e plehrave kimike.
- Tashme eshte krijuar nje tregeti e stabilizuar e ketyre produkteve.
- Kerkesa per plehra kimike eshte e vazhdueshme dhe ne rritje kjo burron nga fakti i domosdoshmerise se tyre per ushqimin e bimeve dhe rritjen e rendimenteve per njesi prodhimi.
- Rritja e rendimentit te produkteve nga perdorimi i plehrave kimike ben qe te shtohen perdite e me shume perdoruesit e tyre.
- Kompanite importuese te cilave ju referohet dhe ky studim operojne ne te gjitha harten e Shqiperise dhe mbeshtetin fermere apo dhe ferma me nje vendodhje mjaft te pershtatshme prane tokave bujqesore. Kjo krijon mundesine e frekuentimit jo vetem nga zona me toke te varfer por dhe te tokave disi me pjellore.
- Ofrojne ne treg game artikujsh marke ne baze eskuziviteti nga kompani komisionere te lidhura me prodhues prestigioze ne bote.
- Infrastrukture eficente te rrjeteve shperndarese te brendeshme.
- Ne tregjet meshtetese te importuesve klientet mund te gjejne te gjitha gamen e produkteve te plehrave kimike qe jane prezent dhe ne bote.
- Cmimet qe ofrojne importuesit jane te konkurueshme me ato te tregejev rajonale fqinje si Maqedonia, Mali i Zi e Kosova.
- Fuqia e madhe financiare e importuesve ju krijon mundesine atyre te sjellin plehra NPK shume efektive dhe me cmime promocionale si fillim.
- Firmat importuese kane aftesi te medha stokimi ne game te gjere artikujsh

Pikat e dobta:

- Mos njohja e mire e perdorimit dhe mungesa e ndergjegjesimit te konsumatoreve per plehrat kimike te tipeve te reja te NPK-^{ve}.
- Aftesia e ulet blerese e klienteve te ketyre produkteve (per shkak dhe te nje bujqeie pa suvencion) ben qe rritmet e ritjes se perdorimit te tyre produkteve te jene ende larg parametrave.
- Mungesa e nje banke bujqesore per kreditimin e blerjes se ketyre produkteve per sezone me cikel 1-2 vjet dhe me interesa te vogla perben nje veshtiresi ne zgjerimin e ketij tregu.
- Puna individuale ne fshat ben qe te mos zhvillohet tregeti me shumice per konsumatorin fundor gje qe ben edhe me te shtrenjte produktin.

- Mungesa e infrastruktures se mjeteve qe perdoren per pleherim ne shume zona eshte nje pengese per futjen e plehrave te tipeve te reja.
- Vete importuesit nuk bejne shume promocion mbi efektivitetin e plehrave kimike te tipeve te reja.
- Eshte nje kontradikte midis plehrave kimike dhe cilesise se produktit. Sa me bio produkti aq me pak plehra duhen, por do te kemi rendiment te ulet. Sa me shume plehra rritet rendimenti aq me shume lende jo te tretshme dhe te demshme per shendetin e njeriut ka ne produkt.
- Plehra qe rrisin shume rendimentet dhe me elemente te demshme qe ti kalojne bimes ka por jane shume te shtrenjta.
- Distributoret rendin mbas nje fitimi te madh dhe ka patur raste qe kane shtuar elemente jo te vlefshem ne plehra per te ritur artificialisht sasite e shitjes.
- Situata e paqendrueshme politike ne rajon ben qe investoret e huaj te kesaj fushe ende te hezitojne per te investuar ne Shqiperi.
- Synohet te ofrohen e shiten plehra kimike vetem ne vendet me konsum te madh. Aty perqendrohen te gjithe importuesit. Keshtu ndryshe eshte intensiteti i pikave shperndares te plehrave ne Lushnje e Fier ku ka nje denduri te madhe dhe krej tjetër panorame kemi ne zonen Librazhd Peshkopi dhe zonen Permet Skrapar.

Shanset:

